



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

## **Procesverbal i takimit të tretë të Grupit Punues për Çështje Teknike**

---

### **SHËNIME PËRMBLEDHËSE TË MBLEDHJES SË TRETË TË GRUPIT PUNUES PËR ÇËSHTJE TEKNIKE**

---

Data: 18 Dhjetor 2010

Koha:

Vendi: Restaurant Rings, Prishtinë

Të pranishëm:

1. Naile Krasniqi, Kryesuese, KPM
2. Sadija Nikšić, KKPM
3. Besim Govori, KPM
4. Besim Rexhepi, KPM

Anëtarë të GP

5. Fatmir Berisha, KTTN
6. Visar Hoti, AMPEK/Mediat Lokale
7. Besnik Berisha, ART
8. Besar Spahija, KTV

Jo të pranishëm:

1. Luan Latifi, KPM

Të pranishëm të tjerë:

Procesmbajtësi: Sekretariati/Pro Consulting

---

### **Përshkrim i përgjithshëm:**

Nën organizimin e Komisionit të Pavarur për Media me datë 18.12.2010 u mbajt mbledhja e tretë e Grupit Punues për Çështje Teknike (GPÇT). Ky grup është njëri nga gjithsejt 5 (pesë) Grupet Punuese (GP për Informim, GP për Çështje Teknike, GP për Çështje Ligjore, GP për Çështje Shoqërore-Ekonomike) të mandatuara për të përpiluar Strategjinë për Digjitalizim të Republikës

së Kosovës. Punën e grupit punues e kryeson Znj.Naile Selimaj Krasniqi, Anëtare e Këshillit të KPM-së (tash e tutje Kryesuese i GPÇT-së).

### **Fjala Hyrëse:**

Kryesuesja hapi takimin. Ajo sqaroi se Sekretariati ka bërë punë të mirë duke e bërë transkriptën e mbledhjes së kaluar kështu ua mundësoi të gjithë anëtarëve të kuptojnë dhe të jenë të njoftuar mbi qëndrimin e Z.Demartino, Ekspertit nga Rregullatori Italian, AGCOM. Ajo ftoi anëtarët të japin komentet e veta dhe pastaj të aprovohet ky transkript/procesverbal. Vërejtjet e bëra do të inkorporohen në procesverbal dhe në parim procesverbali aprovohet.

**Z. Besnik Berisha nga ART:** Brezi frekuencor i propozuar nga unë është 790 - 862. Gjithashtu, te pjesa ime duhet të ceket që duhet t'u përmbahemi trendeve të EU.

**Naile Krasniqi, KPM:** I përkujtoi antarët e GP që në takimin e kaluar ishin pajtuar për një demonstrim të planit alternativ nga Zyra e KPM-së. Kryesuesja ftoi Besim Govorin dhe Besim Rexhepin nga KPM-ja të prezantojnë Planin Alternativ për Frekuenca të Kosovës. Ajo shpjegoi që ky plan është hartuar me softuerin ICS telekom. Kryesuesja ftoi pjesëmarësit të bëjnë propozime konkrete rreth këtij plani. Ajo gjithashtu shtoi se plani alternativ krijon shtatë (7) rrjete kombëtare duke pasur parasysh edhe transmetimin aktual që bëhet në Kosovë, gjë ka munguar në marrëveshjen Gjeneva 2006. Ju keni bërë komente rreth Goleshit dhe Cviljenit dhe arsytet pse këto pika nuk janë të përfshira në planin alternativ. Arsyeja e mospërfshirjes është sepse ato dy pika nuk janë funksionale për momentin, por, sidoqoftë, nëse ato mund të funksionalizohen, nuk do të jetë problem të përfshihen në planin alternativ. Ju ftoj që të jipni komente konkrete për planin që do të paraqitet para jush nga zyra jonë.

**Besim Govori, KPM:** plani alternativ është punuar nga 2 ekspertë të pavarur. Njeri nga ekspertët, Elton Poga, është ish puntor i rregullatorit të Shqipërisë dhe pjesëmarës i negociatave Gjeneva 2006, si pjestar i delegacionit të Shqipërisë. Poga është plotësisht i informuar rreth problemeve që ne balafaqohemi sot, si ato teknike, ashtu edhe ato administrative për shkak të mosqenies antar i ITU-së. Mund të them pa hesitim se të dy ekspertët kanë dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh në përpilimin e një dokumenti i cili tash është duke u plotësuar dhe ndryshuar në këtë grup punues. Unë dhe Besim Rexhepi kemi shërbyer si mbështetje për dy ekspertët. Ky projekt (plani alternativ) është punuar me dy softuera më të sofistikuar në botë, softueri ICS telekom dhe baza e shënimeve të ITU për pjesën e telekomunikacionit. Është një bazë e shënimeve e ITU që është shumë e pasur me informata, të cilat mund të shfrytëzohen nga rregullatorët e ndryshëm për nevojat e veta. Analizat në teren i kemi bërë me softverin ICS që e disponojmë në KPM, softuer ky që mund të përdoret edhe për transmetime analoge edhe për ato digjitale. Ju e keni pasë në dispozicion planin alternativ, dhe procesi i digjitalizimit është përcjellur me një numër konferencash e takimesh, kështu që të gjithë jemi të njoftuar me historikun e procesit. Kosova nuk ka pasur mundësi t'i mbrojë interesat veta gjatë konferencës Gjeneva 2006 sepse nuk kemi qenë pjesëmarës në këtë konferencë. Prandaj, gjatë hartimit të planit alternativ kemi pasur kufizime që kanë rrjedhë nga plani i ITU-së me të cilin Kosova është planifikuar në allotmente të Republikës së Serbisë. Kështu që, me këtë plan, ne kemi tentuar që kanalet që janë të planifikuara të janë legale dhe të pranueshme për rregullatorët tjerë dhe ITU. Pra, plani alternativ është ndërtuar në kanalet e mbetura që nuk janë në shfrytëzim nga Shqipëria,

Mali i Zi, Maqedonia, Sërbia. Ndarja e Kosovës në zona është bërë për t'ju ikur interferencave nga shtetet fqinje.

*(Besim Govori bëri një demonstrim të planit frekuencor që e ka negociuar Serbia dhe planit alternativ që e ka hartuar KPM.)*

Z. Govori vazhdoi prezantimin duke i informuar të pranishmit që Serbia nuk ka bërë asnjë tendencë për të koordinuar frekuencat e Kosovës me shtetet fqinje. Ata e kanë konsideruar Kosovën si një allotment brenda Sërbisë. Të dhëna teknike për Kosovë mungojnë, edhe pse janë përcaktuar pikat e Goleshit dhe Cviljenit. Është përcaktuar vetëm fuqia e transmetimit.

Gjatë përpilimit të planit alternativ, një faktor i rëndësishëm ka qenë gjendja ekzistuese në planin frekuencor. Momentalisht ne kemi 20 pika transmetuese që janë paraqitur në prezantim. Nga kjo shihet se, në krahasim me gjendjen reale, plani i Sërbisë lë jashtë planifikimit 48% të territorit. P.sh. allotmenti i Kopaonikut përfshin edhe Vushtrinë. Serbia nuk ka kurfar parametra për Kosovën. Nëse krahasoni planin alternativ dhe planin e negociuar nga Serbia, shihet se të dhënat që i ka pasë Serbia janë të pakta dhe mungojnë shumë informata.

**Fatmir Berisha, KTTN:** ITU na i ka dhënë frekuencat në Golesh dhe Cviljen. Ne po kërkojmë rrjetet SFN të funksionojnë në më së paku 10 “assignments” apo pika, për të formuar SFN e multipleksit 1 dhe 2 që po supozojmë se do të planifikohet në ato pika. Atëherë, zonat që janë jashtë mbulimit të Goleshit dhe Cviljenit do të duhej të shkonin në koordinim me shtetet fqinje. Zgjedhje tjetër nuk kemi dhe plani duhet të bëhet me të gjitha pikat e transmetimit që i kemi dhe pastaj të shtohet plani sekondar, për allotmente (sub-allotmente).

**Besim Govori, KPM:** Ky është propozimi alternativ (prezanton në ekran). Nëse e qesim edhe allotmentin e planit të miratuar nga ITU dhe e krahasojmë me planin e propozuar nga KPM (në ekran paraqitet dallimi) mund të shihni dallimin e mbulueshmërisë.

**Visar Hoti, AMPEK:** d.m.th të gjitha kanalet që janë dhëna nga ITU nuk kanë interferencë për Kosovë. Mirepo plani alternativ ka planifikuar më shumë kanale për rafshin e Dukagjinit. Planin alternativ është një bazë e mirë për të filluar me përcaktimin e “assignments” por, për përcaktimin e allotmenteve, ka ende shumë punë për t'u bërë. Ne mundemi të flasim vetëm për “assignments” (pika transmetuese). Ne kemi mundësi të nxjerrim 7 FSN rrjete kombëtare dhe 6 MFN rrjete. Ne mundemi praktikisht të kemi 13 multiplekse, 7 SFN dhe 6 MFN, me keto “assignments” (pika transmetuese).

**Besimi Govori, KPM:** prezantoi kanal 44 dhe interferencat e mundshme në këtë kanal.

**Fatmir Berisha KTTN:** A janë kanalet e ITU-së të përfshira në allotmente dhe në cilin allotment janë të përfshira?

**Besimi Govori, KPM:** Po. Janë të përfshira në allotmentin e anamoravës, përvec kanalit 21.

**Visar Hoti, AMPEK:** Unë shoh 2 allotmente, rrashfin e Dukagjinit dhe të Kosovës. Nuk kuptoj pse i kemi 3 allotmente në plan. Pra, këto allotmente duhet të përdoren për planifikimin e rrjeteve

rajonale kurse allotmenti nacional për rrjete SFN (Single Frequency Network). Visari praqiti disa brenga rreth planit alternativ. Në SFN nacional plani jep mundësi për tre multiplekse.

**Naile Krasniqi, KPM:** Ju lutem të jeni konkret me verejtjet që i bëni që ato të merren parasysh më lehtë nga KPM.

**Visar Hoti, AMPEK:** Brengë konkrete është: kanali 48 është paraparë vetëm për anamoravë, kurse ITU na e ka dhënë për krejt Kosovën. Besim, a mundesh ta shpjegosh arsyen.

**Besim Govori, KPM:** Arsyeja pse nuk është përdore është interference me shtetet fqinje.

**Visar Hoti, AMPEK:** Ne duhet ta dijmë me cilin shtet interferon.

**Besim Govori, KPM:** Nuk është e rëndësishme të koncentrohemi te kanali, cili kanal po përdoret në cilin vend, sepse ne mund të përdorim kanale tjera për të krijuar SFN. Çështja është se ne duhet të vendosim sa SFN dhe sa MFN rrjete mund dhe duam të bëjmë. .

**Visar Hoti, AMPEK:** Nuk e kuptoj pse në planin alternativ, kanalin që është caktuar nga ITU e kemi nda në 3 pjesë, kur Gjeneva 2006 e ka garantuar si kanal që nuk interferon me shtetet fqinje.

**Naile Krasniqi, KPM:** Të lutem Besim gjeje kanalin 31 dhe tregoi interferencat.

**Besim Govori, KPM :** Ja ku është kanali 31 dhe nuk ka interferenca.

**Visar Hoti, AMPEK:** pse e kemi nda në 3 pjesë kanalin 31 në plani alternativ, në kanalin e allotmentin e Kosovës.

**Besim Govori, KPM:** në principet e interferimit shtetet mund të thone që edhe nëse ka interferencë, themi në një pikë shumë të largët, shteti nuk ta lejon. Në rastin e kanalit 31 interferenca ishte dikund në Mal të Zi.

**Visar Hoti, AMPEK:** mirepo, kanali është i garantuar me marrëveshjen e Gjenevës. Në anën tjetër Serbia mund të interferojë deri në Ferizaj.

**ART:** Kanali 31 është i garantuar me ITU në allotmentin e ashtuquajtur “Kosovë dhe Metohi” i cili nuk e mbulon të gjithë teritorin e Kosovës.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Duhet të definohen disa gjëra se kështu nuk mbrijmë askund. Plani alternativ nuk merr parasysh SFN rrjetet. Ky plan nuk i potencon ato. Ta qartësojmë: planifikimi do të duhej të merrte për bazë frekuencat e ITU, dhe ti pranojë ato, me një ngritje të fuqisë prej 40 DPM si është planifikuar në planin e ITU-së, në 50 DPM vetëm për pikën e Goleshit. Tjetërkund nuk na duhet ngritja e fuqisë, se edhe ne nuk kërkojmë dicka që nuk na duhet. Mirepo, ato kanale (të ITU-së) unë popozoj të shfrytezohen komplet për SFN në të gjithë teritorin e Kosovës. Pastaj, tre sub-allotmentet ndahen për t'u përdorë për nevoja rajonale.

Edhe pse KPM-së i del punë për të bërë këto ndryshime, do të duhej që kanalet e ITU-së të përcaktojnë për territorin e Kosovës për SFN netëork.

**Visar Hoti, AMPEK:** Sa i përket kësaj pjese (tregon në hartë pjesën veriore të Kosovës), është shumë reale dhe optimale me të kërku pikat testuese me të dërgu në veri.

**ART:** mirepo plani duhet të koordinohet me shtetet fqinje, pa mare parasysh ndryshimet.

**Naile Krasniqi, KPM:** Cila është kërkesa konkrete e jote, Visar? Me sa kuptova une, kërkesa është që plani i ITU-së të mbetet ashtu si ka qenë pra kanalet 21, 31, 48, 58, 68 etj. që në cdo allotment të ndare të ekzistojnë keto kanale. A është kështu?.

**Visar Hoti, AMPEK:** Që të përdoren kanalet e caktuara të ITU për SFN.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Ne nuk duhet me të ikë qëllimit të KPM-së që dëshiron të krijojë më shumë frekuenca se sa janë paraparë me planin e ITU. Propozimi im, të cilin dua ta diskutoj sot me ju këtu në këtë grup Punues është që rrjeti SFN të bazohet në frekuenca të ITU-së për krejt territorin e Kosovës. Dhe të krijohen 2, 3 ose 4 suballotmente, duke pasë parasysh edhe suballotmente për nevojat e minoriteteve. Nëse jeni dakord me këtë princip, ju duhet t'i bëni rrjetet SFN për të gjitha kanalet e aprovuara nga ITU.

**ART:** Do të jetë shumë vështirë për të krijuar një SFN me pikat e dhëna.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Plani global duhet të përfshijë SFN dhe suballotmente duke përfshi edhe një sub-allotment për Prishtinën. Është gabim i madh i imi, që jam duke e pranuar tani, që nuk ua kam dorëzuar kuotat e propozuara prej grupit punues intern me koordinata të sakta që ajo pastaj të merrej për tu analizuar se si mundet të inkorporohet SFN-i kombëtar dhe regjional përmes të njejtave pika duke llogaritur planin e mbulimit sekondar jashtë atyre pikave transmetuese, prandaj edhe propozimi im është që bashkarisht ta bëjmë një plan Global. Une e dhash propozimin tim. Tani duhet që ai propozim të diskutohet. Plani Global është – po e përsëris edhe një herë - një rrjet SFN dhe gjithashtu të planifikohet sub-allotmenti i Prishtinës, sepse çdo shtet e ka sub-allotmentin e kryeqytetit.

**Naile Krasniqi, KPM:** Ndoshta do të ishte mirë ta pranojmë këtë ndarje me plotësimin që do ta bëjmë për 6 ose 7 kanale që të konsiderohen si allotment kombëtar, që kanalet të shfrytesohen në tërë Kosovën. Duhet të kemi parasysh që duhet të jetësohet përdorimi i Goleshit dhe Cviljenit. I vetmi propozim që po e shoh është që kanalet e ITU-së të përdoren për SFN, edhe pse ITU nuk i garanton këto për krejt Kosovën. Duhet të ndryshojnë parametrat teknike për t'i përdorë këto kanale për SFN në të gjithë territorin e Kosovës. Dhe për këtë duhet shumë punë. Koordinimi i parë fillon nga ne dhe pastaj duhet të fillojë koordinimi me shtetet fqinje. Mirepo ne duhet të pajtohemi për atë se cila pjese e planit alternativ po parnohet dhe cila pjesë duhet të ndryshohet. Në bazë të kësaj, KPM do të planifikojë për nevojat nga aspekti i ekspertizës që na nevojitet dhe ta kemi të qartë drejtimin në të cilin po shkojmë.

**Visar Hoti, AMPEK:** Parimi i parë: të bëhet shfrytëzim sa më racional i mundësite e dhëna dhe ato mundësi që ne i krijojmë. Rrjeti SFN është i sinkronizuar ndërkombëtarisht dhe shumë pak

punë na ka mbete me ITU në këtë aspekt. Sa i përket sub-allotmenteve ato janë çështje tona të brendshme, përderisa nuk interferojme me shtete fqinje. Në krahasim me këtë plan, ne kemi mundësi të planifikojmë 7 rrjete SFN dhe minimum 4 deri në 6 rrjete MFN.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Anketimi është nisma për planifikim të mirefilltë. Pastaj në bazë të kërkesave të televizioneve, KPM bën planifikimin e rajonalizimit. E vetmja mënyre për të nxjerrë frekuenca të reja është të bëhet regjonalizimi i televizioneve, dhe këtë na e tha edhe eksperti nga Italia. Përndryshe, në të gjithë territorin e Kosovës i kemi 6 multipleksa, 2 tash dhe 4 me vonë dhe VHF i cili planifikohet për DVBH.

**Visar Hoti, AMPEK:** Edhe një çështje tjetër. Ne jemi pajtuar për standardin DVT 264 H AVC. Ky ka qenë propozimi për të cilin jemi dakorduar. Tani Kosova duhet të planifikojë që të gjitha televizionet të kalojnë në HD. Duhet tu thuhet transmetuesve se duhet të kalojnë në HD.

**Naile Krasniqi, KPM:** Si rekomandim i Grupit Teknik mund të konsidohet se propozimi është: plani alternativ është pranueshëm me plotësim që duhte të krijohen rrjetet SFN.

Të pranishmit u pajtuan që plani për të cilin flasim është plan i cili do të realizohet pas periudhës “switch – off”.

**Visar Hoti, AMPEK:** Duhet të përgaditet plani i Simulkastit dhe plani pas periudhës “switch – off”, me parametrat të cilat u diskutua deri më tani. Këtë plan mundemi ta qesim në letër për një javë. Mandej nise simulkastimiimi.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Janë disa parakushte. Unë konsideroj se si Grup Punues mundemi të kërkojmë nga KPM që të shfrytëzohen dy kanale në tërë territorin e Kosovës për simulkast, të punohet në kanalet 46 – 58. Këto dy kanale mjaftojnë. Testet mundemi me i fillu vetëm në Prishtinë. Mirepo, kur fillon testimi, atëherë ne do të vazhdojmë t’i lidhim pikat tjera, që të dijmë se si është gjendja e interferencës së mundshme, dhe sa janë gjasat për interference. Këto matje do të zgjasin 1 deri në 2 muaj.

**Naile Krasniqi, KPM:** Ti riformulojmë rekomandimet:

1. Kanalet e allotmenteve të përshihen në 7 (shate) rrjete SFN.
2. Puna të planifikohet në dy faza: faza e simulkastit dhe faza pas “switch off-it”.

**Visar Hoti, AMPEK:** Numri i allotmenteve të rishiqohet. Kosovës i duhet 1 allotment i përgjithshëm (kombëtar) për SFN kombëtar dhe 2 sub-allotmente.

**Fatmir Berisha, KTTN:** me lejoni ra rezymoj: Hapi i Parë: shqyrtimi i dy kanaleve të dhëna nga ITU, kanali 46 dhe 58, të shihet sa është pastertia. Hapi i Dytë: Startimi i një programi eksperimental në kanalin 46. Hapi i Tretë: Të analizohen kërkesat e televizioneve dhe të vleresohen sa reale janë, për të planifikuar për të ardhmen. Kërkesat jo-reale nuk duhet të merren parasysh.

**Naile Krasniqi, KPM:** KPM ka informata të bollshme për të vlerësuar kapacitetin e televizioneve. Unë kam dëshirë që nga plani teknik të shihet se çka është e pranueshme. Kur kemi një plan të pranueshëm, me modifikimet e kërkuara, të fillohet koordinimi me shtetet fqinjë, e më vonë edhe me ITU, kur të pihen kushtet. KPM duhet të ketë parasush se gjerat do të ndryshojnë.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Duhet t'i dijme edhe nevojat e rajonit në bazë të së cilave caktohen planet frekuencore nëpër allotmente. ITU-së nuk i intereson si ne e rregullojmë planin brenda allotmenteve. Propozimi i Grupit Punues është që KPM ta bëjë analizen e interferencës në keto dy kanale, pastaj KPM të bëjë të mundur subjekteve transmetuese që janë të interesuara të leshojnë sinjale testuese digjitale, duke përfshi edhe TV lokale. D.m.th. fillimisht KPM duhet të planifikojë për dy multiplekset. Për momentin në pikpamje teknike duhen dy multiplekse, njeri për nevojat e televizioneve nacionale dhe tjetri për ato lokale. Me vonë, kur të lirohen frekuencat, numri i multipleksave mund të rritet. Në këtë situatë ne duhet të lëshojmë sinjale testuese për tu siguruar në realizshmërinë e digjitalizimit. Prandaj na duhet analiza e interferencës në keto dy kanale, që të dijme se ku mundet të kemi probleme. Sa ma shpejtë të përfundohet puna me kanalin 46 dhe 58 aq ma shpejt do t'i lirojmë kanalet analoge, dhe gjithashtu i përgadisim edhe qytetaret për tu pajisur me set-up boxa, aq ma shpejt fillon perioda e simulcastimit dhe kalimi në transmetim digjital.

**Naile Krasniqi, KPM:** Hapi i parë për KPM-në është që plani i Kosovës të jetë i pranueshëm për të gjithë. Pastaj duhet të bëhen analiza për interferenca në kanalet 46 dhe 58, të bëhet një agjendë kohore për realizimin e planit. Neve na nevojitet një miratim i grupit punues që plani alternativ, me plotesimet që u kërkuar nga Grupi Punues për rrjetet SFN kombetare, mund të jetë i pranueshëm nga grupi. Mua më duhet të dij nga ju si Grup Punues, se a mund të konsiderojmë se kjo është e pranueshme.

**Fatmir Berisha:** Per me startu punën është e mjaftueshme.

**Naile Krasniqi, KPM:** Më intereson të di, a kanë vendet përreth rrjete SFN-a kombetare?

**Fatmir Berisha, KTTN:** Rrjetet SFN janë aplikuar në pak vende por është teknologjia më e re. Në kemi mundësi të fillojmë me SFN sepse nuk kemi gjendje ekzistuese të transmetuesve digjital por po fillojnë nga fillimi.

**Visar Hoti, AMPEK** porozoi që të përdoret një softuer i specializuar për të planifikuar rrjetin SFN. **Besim Rexhepi, KPM** tha se ka mundësi që softueri i KPM-së të baj këtë, por mbeti që kjo pike të qartësohet. **Fatmir Berisha, KTTN** tha se nuk mjaftojnë vetëm simulimet softuerike pa u testuar sinjali në teren se mund të bëhen gabime. Ai theksoi se edhe shtetet si Gjermania kanë gabuar dhe pastaj ato gabime kanë kushtuar shumë. Prandaj duhet të shkojmë hap pas hapi.

**Naile Krasniqi, KPM:** prandaj duhet të sjellim ekspertët nga ITU të cilët duhet të punojnë me grupin e ngushtë teknik që të arrijmë te një plan i qëndrueshëm. Në këtë takim KPM mori rekomandime konkrete. KPM do të sjell eksperizën për t'i implementuar këto rekomandime, pas vitit të ri.

**Fatmir Berisha, KTTN:** përmendet shpesh puna e pikës së Cvilenit që të mbetet si punkt. Nëse e dijmë se Zatriqi i ka parametrat më të mira, atëherë duhet të bëjmë një kërkesë në ITU që Cvileni të zëvendësohet me Zatriq. Ne e dijmë se Cvileni ka qenë gjithmori pikë jo e mirë. Besoj se nuk do të jetë problem të negociohet kjo me ITU. Dragashi pastaj mbulohet përmes Goleshit.

**ART:** A ka KPM bashkepunim me ITU.

**Naile Krasniqi, KPM:** KPM planin Alternativ e ka dorëzuar në ITU, por nuk jemi antarë në ITU. Mirëpo, ne kjo nuk na ndalon punën në përpilimin e planit frekuencor digjital.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Ne nuk kemi nevojë t'i thejmë rregullat e ITU. Panit alternativ që u përpilua nga dy ekspertët e agazhuar nga KPM i mungon SFN-i kometar.

**Naile Krasniqi, KPM:** Tani i kemi rekomandimet. Ju lutem të kalojmë në diskutimin e pyetsorit që e ka përgaditë Sekretariati.

**Visar Hoti, AMPEK:** Para se të kalojmë te pyetsori, ta diskutojmë një çështje tjetër. Si do të mbetet çështja e punës së Grupeve Punuese nëse nuk ka Këshill të KPM-së dhe nuk kemi Kuvend të konstituar. Si po mbetet çështja e legjitimitetit të këtyre Grupeve Punuese.

**Naile Krasniqi, KPM:** Ne duhet ta afrojmë punën dhe të kemi koncensus para se ta paraqesim punën në Kuvend. Ne besojmë se antarët e rinj të Këshillit do të kemi së shpejti.

**Visar Hoti, AMPEK:** A ka mundësi të bëhet një informim të publikut rreth punës së bërë deri më tani? Të organzohet ndonjë konferencë për shtyp dhe të informohet publiku.

**Naile Krasniqi, KPM:** Kjo nuk është problem.

**Visar Hoti, AMPEK:** Ne duhet ta përgadisim edhe një pako të çështjeve që duhet të diskutohen me Serbinë.

**Naile Krasniqi, KPM:** Besoj se deri në muajin shkurt do të kemi institucione, por edhe ne nëpër Grupe Punuese kemi mjaft punë për t'u përgaditur për ta prezantuar punën tonë. Në gjysmën e dytë të këtij viti duhet të behemi gadi të fillojmë koordinimin me shtetet fqinje. Mirëpo kjo duhet të fillojë pasi që plani frekuencor të pranohet nga ne si Grup Punues, pastaj që ky plan të pranohet nga Kuvendi.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Si Grup Punues ne do të kemi punë edhe me ART-në për punën e linqeve, që është përgjegjësi e ART-së. Mirëpo, puna e përcaktimit të linqeve nuk ka të bëjnë me ITU.

**Visar Hoti, AMPEK:** ART duhet ta ketë parasysh që licencat e linqeve të mos jenë më të shtrenjta se licencat tona për transmetim.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Insitimi im do të jetë që të shfrytëzohen të njejtat frekuenca, që ART të ketë sa më pak probleme.



**ART:** parimi ynë është të përdoret brezi frekuencor në mënyrë efikase.

**Naile Krasniqi, KPM:** Të kalojmë te pyetsori. Pyetsori do të shqyrtohet nëpërmes e-mailit. Githashtu në procesverbal duhet të përmendet se RTK, si transmetues publik duhet të merr pjesë në punën e procesit të digjitalizimit. RTK nuk po tregon interesim në këtë proces dhe është jo aktive në punën e Grupeve Punuese. Për shembull, në Grupin Punues për Çështje ligjore është propozuar që të amandementohen ligjet e RTK-së dhe KPM-së. Mospjesëmarrja e RTK-së është problematike.

**Fatmir Berisha, KTTN:** Ne e bëmë një rekomandim për tu bere disa matje per kalin 46 dhe 58. Pyetja eshte se a është ne gjendje KPM t'i bëjë keto matje dhe kur do ti beni.

**Naile Krasniqi, KPM:** Unë ua dhash përgjigjen: KPM ka interes që së pari të pajtohem për planin alternativ. Pastaj KPM do të vendos se cilat kanale do përdoren për testim. Por në fillim na duhet pajtueshmëria për planin alternativ. Pastaj KPM vendos për kanalet dhe fazën e simulcastimit.

**ART:** Nuk duhet me u ngutë, planifikimi është faza kryesore dhe ndoshta duhet të mos kursehem për kohën dhe ekspertizën që nevojitet, por planifikimi duhet të jetë i mirë. Ne jemi duke e koordinuar planin tonë frekuencor për telefoni mobile me shtetet fqinje dhe kjo po na merr kohë. Ekzistojnë parametrat e lejueshmërisë së kalimit të frekuncave në territorin e shtetit fqinj.

**Naile Krasniqi, KPM:** Çështja e pyetsorit. Të pajtohem që deri më 10 janar të ipen vrejtit për pyetsor.

Grupi punues u pajtua që informatat që do të merren nga mediat nuk do të jenë reale dhe ato do të paraqesin një listë dëshirash. Mediave ju mungojnë informata të mjaftueshme për koston e digjitalizimit të tyre të brendshëm dhe informata të tjera. Kjo duhet të merret parasysh gjatë analizës së të dhënave. Për shembull, subjektet transmetuese duhet të përgjigjen për modalitetet e Multiplekseve, për të cilat ata nuk kanë shumë dijeni. Fatmiri Berisha do t'i dergojë KPM-së kuatat e koordinatave për të dyja sistemet. Në takimin i radhes KPM do ta paraqes draftin e përgjithshëm me ndryshimet që do të bëhen në pjesën teknike të strategjisë.

TABELA E VEPRIMEVE:

	<b>Lista e Detyrave:</b>	<b>Veprim i kërkuar:</b>	<b>Personi përgjegjës:</b>	<b>Statusi:</b>
	<b>NDRYSHIMET E KËRKUARA NË PLANIN ALTERNATIV:</b> 1. Në bazë të frekuencave të caktara nga ITU, me një ngritje të	<b>KPM</b>	<b>Naile Krasniqi Besim Govori</b>	

	<p>fuqisë nga 40 DPM në 50 DPM në Golesh të palnifikohen SFN rrejete për të gjithë territorin e Kosovës.</p> <p>2. Është kërkuar që të rishiqohet mumri i allotmenteve nga AMPEK (nga 3 në 2 allotmente). Anëtarët tjerë nuk kanë qëndrim rreth kësaj çështje.</p> <p>3. Të shtohet sub-allotmenti i Prishtinës.</p> <p>4. Të ndryshohet pika e Cviljenit me atë të Zatriqit</p> <p><b>KËRKESA TJERA:</b></p> <p>1. Caktimi i dy kanaleve (kanali 46 dhe 58) për transmetim eksperimental.</p> <p>2. Kërkohet nga KPM të bëhen matjet për kanalën 46 dhe 58 për të caktuar SFN-in e mundshëm.</p> <p>3. Të dërgohen koordinatat e pikave transmetuese nga KTTN</p> <p>4. Plani i punës për implementim duhet të ndahet në dy faza: faza e multikastimit dhe faza pas „sëitch Off-it“</p>	<p><b>KPM</b></p> <p><b>KPM</b></p> <p><b>KPM</b></p> <p><b>KPM</b></p> <p><b>KTTN</b></p> <p><b>Grupi Punës</b></p>	<p><b>Naile Krasniqi Besim Govori</b></p> <p><b>Naile Krasniqi Besim Govori</b></p> <p><b>Naile Krasniqi Besim Govori</b></p> <p><b>Naile Krasniqi Besim Govori</b></p> <p><b>Fatmir Berisha</b></p> <p><b>Grupi Punues</b></p>	
--	--	--	---	--

	<b>PYETSORI:</b> 1. Të dërgohen komentet në pyetsor deri me datën 10 Janar 2011.	<b>Anëtret e Grupi Punues</b>		
--	---	-------------------------------	--	--